



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2851

Nr. koleksioni: 1082

Tirane më 05/04/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë". i ndryshuar



A2022053950322713879

Taksa e Pullës
u Likujdua



A2022053950322713879

KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot, në Tiranë, me 05/04 / 2023, përpara meje Julian Zhelegu, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, lidhet kjo Kontrate Shitje Kuote nga dhe ndërmjet:

SHITESI:

1. **Klaudio Fushaj**, atësia Pjerin, amësia Alma, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë Sulejman Delvina; Njësia Administrative Nr. 5; 0000; Tiranë, lindur më 11/02/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032085432 dhe nr. personal J502110370;

(ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si "Shitësi")

dhe

BLERESI:

1. **Arjan Hysa**, atësia Enver, amësia Zymbyle, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Z Curre; Njësia Administrative Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 04/12/1956, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034618885 dhe nr. personal F61204068H;

(ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si "Blerësi")

Palët e mësipërme ne vijim dhe për efekt te kësaj Kontrate, do te referohen individualisht si "Pale/a" dhe se bashku si "Pale/et".

MEQENESE:

- A. Shitësi është ortak zotërues i 1 (një) pjese që përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ALPO INVEST" shpk. (ne vijim "**Shoqëria**"), shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS L74418601L dhe me seli ne Korçë, Buçimas, Rruga e Drilonit, prane Karburant Zhudi, Kompleksi ASG, Nr. 19, kapitali themeltar i regjistruar i te cilës është ne shumen ALL 2.000, sikurse rezulton nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- B. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit të gjithë pjesën e vet të kapitalit te Shoqërisë (gjithsej 25% - njëzet e pesë përqind te kapitalit) (ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si "**Kuota**") dhe Blerësi dëshiron te blejë Kuotën.
- C. Ne përputhje me statutin e shoqërisë, palët deklarojnë se kalimi i kuotave ndërmjet ortakeve aktuale te shoqërisë nuk i nënshtrohet miratimit apo dhënies se pëlqimit nga ortaket e tjerë apo asambleja e ortakeve.
- D. Nga verifikimi i Regjistrimit te Barreve Siguresë, Kuota rezulton te jete e lire dhe e pa barrësuar.

PER SA ME SIPER, Palët ranë dakord për te lidhur këtë Kontrate Shitje Kuote.

NENI 1
OBJEKTI



A2022053950322713879

- 1.1. Objekt i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë së Kuotës nga Shitësi te Blerësi dhe fitimi i pronësisë mbi Kuotën që përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë nga Blerësi, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.
- 1.2. Me lidhjen e kësaj Kontrate pronësia mbi Kuotën kalon nga Shitësi te Blerësi dhe Blerësi bëhet ortak zotëruar i 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "ALPO INVEST" shpk.

NENI 2

ÇMIMI DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1. Çmimi i shitjes së Kuotës që përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë është EUR 10.000 (dhjetë mijë Euro). Çmimi i shitjes gjendet i drejtë dhe i arsyeshëm. Çmimi i shitjes do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga lidhja e kësaj Kontrate në llogarinë bankare të Shitësit me nr. IBAN AL42 2121 1009 0000 0000 00725449 në EUR pranë Credins Bank.

NENI 3

KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTEN

- 3.1. Pronësia mbi Kuotën që përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë do të kalojë nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, e cila do të regjistrohet menjëherë në librat e Shoqërisë si dhe në Regjistrin Tregtar sipas ligjit.
- 3.2. Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë, me lidhjen e kësaj Kontrate, do të jetë si vijon:
 - z. Arjan Hysa zotëruar i 1 kuote që përfaqëson 75 % (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit;
 - z. Florian Uldedaj është zotëruar i 1 kuote që përfaqëson 25 % (njëzet e pesë përqind) të kapitalit;
 - z. Klaudio Fushaj largohet nga Shoqëria.

NENI 4

DEKLARATA DHE GARANCI

- 4.1. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:
 - a. Shoqëria ekziston në mënyrë të ligjshme dhe kryen veprimtarinë tregtare sipas objektit të saj të deklaruar.
 - b. Shitësi është zotëruar i vetëm i Kuotës dhe ai gëzon gjithë të drejtat e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga Kuota dhe ka tagra të plota për të shitur Kuotën e zotëruar prej tij. Kuota është nënshkruar dhe paguar plotësisht.
 - c. Kuota e zotëruar nga Shitësi është lirisht e transferueshme dhe asnjë miratim tjetër nuk nevojitet për realizimin e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate.
 - d. Kuota është e lirë nga çdo lloj pengu, detyrimi, takse, pretendimi, të drejtë parabletjeje, apo barre tjetër dhe asnjë person i tretë nuk ka asnjë të drejtë reale apo garancie mbi Kuotën.
 - e. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Shitësi është palë.
 - f. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklaratat dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.
- 4.2. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:
 - a. Blerësi ka tagra të plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.



A2022053950322713879

- b. Blerësi deklaron e garanton se e njeh gjendjen financiare dhe kontabël të Shoqërisë dhe se dëshiron të fitojë pronësinë mbi Kuotën pa rezerva të asnjë lloji.
- c. Blerësi do të paguajë çmimin e shitjes sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
- d. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Blerësi është palë.
- e. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

Neni 5

DISPOZITA TË FUNDIT

- 5.1. Kjo Kontrate hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.
- 5.2. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzoleve apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 5.3. Kjo Kontrate përmban marrëveshjen e plote ndërmjet palëve në lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.
- 5.4. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 5.5. Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontratës i bashkëlidhen kopje të dokumenteve të identifikimit të Palëve dhe Aneksi A (Ekstrakt nga Regjistri Tregtar i Shoqërisë) dhe Aneksi B (Ekstrakt nga Regjistri i Barrëve Siguruese).

Unë Noteri e hartova këtë Kontratë sipas kërkesës së Palëve në gjuhën Shqipe dhe në katër origjinalë e pasi ua lexova me zë të lartë e të qartë, u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të shprehur përpara meje, nënshkruhet prej tyre rregullisht në praninë time dhe unë e vërtetoj sipas ligjit dhe për të gjithë pasojat e tij.

SHITËSI

Klaudio Fushaj

Klaudio Fushaj

BLERËSI

Arjan Hysa

Arjan Hysa

NOTERI

Julian Zhelegu



Regjistri i Barrëve Siguruese




Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANË, SHQIPËRI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit:	D-20230404152059141
Data e Rezultatit të Kerkimit:	04.04.2023
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	3:20:59PM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-168-4542
Referenca e Perdoruesit:	

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

ALPO INVEST SH.P.K.



Henri Gjoni